



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2081 / prot.
4

Elbasan, me 22.09.2023

VENDIM

Nr 30 datë 22.09.2023

PËR

**NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 10 , DATË
24.03.2023 "PËR MIRATIMIN E PLANBUXHETIT VJETOR 2023" TË UNIVERSITETIT TË
ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI", TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE " Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr. 75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", VKM-n nr. 243, datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 'Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë'", VKM Nr. 325, date 31.05.2023, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile /nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike"; VKM Nr. 326, date 31.05.2023 , "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" lidhja 1; Udhëzimit të MFE Nr. 16, datë 16.06.2023, "Për mënyrën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile / nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike"; Shkresës së MAS nr 2649/60 prot, datë 18.05.2023 (në UE nr. 1174/2 prot datë 19.05.2023) "Dërgohet fondi akorduar për rritjen e pagave për vitin 2023", Shkresës së MFE nr 13010/1 prot, datë 07.08.2023 "Transferim fondi për shpenzime kapitale" (rritja e kapaciteteve infrastruktura akademike kërkimore-shkencore), nr 13190/3 prot, datë 03.08.2023 "Transferim fondi për shpenzime kapitale", Kontratave të kërkimit shkencor me financim nga AKKSHI, Vendimit të Senatit Akademik Nr. 17 , datë 22.09.2023 "Për miratimin e saktësisimit të emërtesave të disa pozicionve të punës të strukturës së miratuar me Vendim nr. 33, datë 09.11.2021 "Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", në kuadër të rritjes së nivelit të pagave të Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", Vendimit të Senatit Akademik nr. 18, datë 22.09.2023 "Për ndryshimin e Vendimit të Senatit Akademik nr. 9, datë 02.05.2023 "Për miratimin e nivelit të pagave, për secilin pozicion pune, të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", Vendimit të Senatit Akademik nr. 19, datë 22.09.2023 "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 04, datë 17.03.2023 "Për miratimin e



planbuxhetit vjetor 2023”, Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 10, datë 24.03.2023 “Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2023” të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, të ndryshuar, Bordi Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në financimet e vitit 2023 duke i paksuar në vlerën 96,302 mijë lekë, sipas burimeve të financimit - Tabela nr. 1, Tabela nr. 1.1, Tabela nr. 1.2, Tabela nr. 1.3;
2. Miratimin e “Planbuxhetit të vitit 2023- të ndryshuar” për Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, sipas burimeve të financimit dhe përdorimin e tyre për çdo grup shpenzimi të aktivitetit ekonomik e financiar në vlerën **1,969,872 mijë lekë** - Tabela nr. 2;
3. Miratimin e listës së projekteve për investime nga Buxheti i Shtetit me (bashkëfinancim) – Tabela nr. 3, Tabela nr. 3.1;
4. Miratimin e listës së projekteve për investime nga të ardhurat e institucionit – Tabela nr. 4;
5. Miratimin e projekteve të kërkimit të infrastrukturës kërkimore-shkencore me financim nga AKKSHI – Tabela nr. 5;
6. Miratimin e projekteve të kërkimit shkencor me financim nga AKKSHI – në vazhdim – Tabela nr. 6;
7. Miratimin e projekteve të kërkimit shkencor me financim nga AKKSHI – viti 2023 – Tabela nr. 7
8. Miratimin e projekteve të kërkimit shkencor nga të ardhurat e Universitetit për financim – të ndryshuar – Tabela nr. 8.
9. Miratimin e projekteve me financim të huaj - UE viti 2023 – të ndryshuar – Tabela nr. 9.
10. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian DURMISHI

